

R E L A C I O N
PËR
PROJEKTLIGJIN “PËR ADMINISTRIMIN E UJITJES DHE
KULLIMIT”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË
SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektligji, siç përshkruhet edhe në nenin 1 të tij, është të përcaktojë kuadrin institucional në funksion të politikës kombëtare për ujitjen, kullimin dhe mbrojtjen nga përmytja; kuadrin ligjor për krijimin dhe/ose funksionimin e strukturave përgjegjëse dhe detyrat e tyre si dhe të rregullojë transferimin, përdorimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës.

Ujitja dhe kullimi janë një nga faktorët kryesorë me ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e qëndrueshme të prodhimit bujqësor në vend.

Shqipëria konsiderohet një vend i pasur me burime ujore, me rreshje mesatare vjetore të bollshme, por për shkak të shpërndarjes së tyre, është e domosdoshme të sigurohet një bilanc optimal i regjimit ujor, nëpërmjet ujitjes gjatë stinës së verës dhe kullimit, veçanërisht gjatë periudhës së dimrit.

Vlerësimet e bëra dhe analizat e thelluara tregojnë se shërbimi i ujitjes dhe kullimit është ende larg të qenit në parametrat e duhur. Për këtë arsye, përmiresimi i menaxhimit të tyre po realizohet nëpërmjet një pakete masash, pjesë e të cilës është edhe hartimi dhe miratimi i një ligji të ri, për administrimin e këtij sektori.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME
PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE
DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Në programin e qeverisë nënvizohet se nuk ka prodhim bujqësor konkurrues pa një sistem funksional të ujitjes dhe kullimit të tokave dhe është marë angazhimi që brenda 4 vjetësh të ketë ujë për vaditje në çdo parcelë të tokës së punueshme.

Ndër masat e këtij programi për rimëkëmbjen e sistemit ujitës dhe kullues parashikohet një rol më i madh i njësive të qeverisjes vendore në mirëadministrimin e burimeve ujore dhe rrjetet ujitës dhe kullues.

Po kështu, strategjia ndërsektoriale për decentaralizimin dhe qeverisjen vendore 2015-2020 parashikon edhe kalimin e funksionit të ujitjes dhe kullimit tek bashkitë.

Përcaktimi dhe ndarja e qartë e rolit, detyrave dhe përgjegjesive në administrimin e sistemeve të ujitjes dhe kullimit, përfshirë edhe atë të bashkive nuk është e mundur të realizohet në kuadrin e ligjit ekzistues nr. 8518, datë 30.7.1999 “Për ujitjen e kullimin”, të ndryshuar.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Aktualisht në shkallë vendi, sistemet e ujitjes janë projektuar për të mbuluar potencialisht me ujitje një sipërfaqe rreth 360 000 ha tokë bujqësore, ndërsa sistemet e kullimit, përfshijnë një rrjet kanalesh kullues, të ndërtuar në 280.000 ha tokë bujqësore, kryesisht në ultësirën perëndimore të vendit.

Komponentët kryesorë të infrastrukturës së sistemeve të ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytja përfshijnë:

- 13 000 km kanale të parë dhe të dytë ujites dhe kullues;
- 626 diga të rezervuarëve të ujitjes;
- 29 hidrovorë për kullim me ngritje mekanike të rreth 75 000 ha;
- 850 km argjinaturat mbrojtëse lumore e detare;
- 300 km kanalet e ujërave të larta;
- 640 stacione pompimi për ujitje nga, të cilët 14 stacione të mëdha pompimi, që mbulojnë me ujitje rreth 20 000 ha.
- 27 800 km kanale të tretë ujitës dhe kullues.

Sipas ligjit në fuqi, nr. 8518, datë 30.7.1999 “Për ujitjen e kullimin”, i ndryshuar me ligjin nr.9860, date 21.01.2008 Ministria e Bujqesisë, është organi kryesor përgjegjës për administrimin e ujitjes dhe të kullimit. Ndërsa administrimi i sistemeve kryhet përmes një ndarje të roleve dhe përgjegjesive mes Bordeve të Kullimit si struktura teknike të specializuara në vartësi të saj dhe Organizatave të Përdoruesve të Ujit (OPU).

Bordet e Kullimit janë përgjegjës për operimin dhe mirembajtjen e sistemeve të kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytja. Ndërkohë, ata kanë vetëm një rol pjesor në administrimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës ujitëse kryesore. Megjithë angazhimin me të madh të tyre në vitet e fundit në rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve ujitës, përsëri përmiresimet nuk kanë qenë thelbësore.

OPU-të janë persona juridik, me vetëfinancim, që nuk ushtrojnë veprimtari fitimprurëse. Ato janë përgjegjëse për operimin dhe mirëmbajtjen e skemave ujitëse, brenda zonës së tyre të shërbimit dhe sigurimin e ujit për ujitje për anëtarët e saj. Burimet e të ardhurave të OPU-ve janë tarifatat vjetore të mirëmbajtjes dhe tarifatat e shërbimit të ujitjes, që paguhen nga anëtarët e tyre (fermerët).

Aktualisht në shkallë vendi, operojnë me shkallë të ndryshme performance, rreth 100 OPU. Megjithatë, në praktikë, menaxhimi i ujitjes me pjesëmarrjen e fermerëve, në fillimet e tij nëpërmjet Shoqatave të Përdoruesve të Ujit, dhe aktualisht nëpërmjet OPU-ve, ka rezultuar larg rezultateve të pritshme. Për shkak të kapacitetit të kufizuar, ato nuk arritën të mbulojnë kostot e operimit dhe mirëmbajtjes së skemave ujitëse, dhe për rrjedhojë, të mos ofrojnë për fermerët ujin në kohën dhe sasinë e kërkuara.

Kjo formë menaxhimi, e suportuar për gati 15 vjet nga projektet e Bankës Botërore, nuk rezultoi e përshtatëshme dhe adekuate për kushtet konkrete të vendit tonë. Kjo edhe për faktorë të tillë si mungesa e traditës kooperuese dhe përvojat negative të mëparshme, mungesa e besimit dhe kohezionit social etj. Kalimi i një përgjegjësie të madhe shoqatave apo OPU-ve në disproporcion me kapacitetet e dobta, përvojën e pakët dhe legjitimitetin e dobët të tyre, kanë çuar në një sistem administrimi të ujitjes dhe kullimit me mangësi të check & balance në zinxhirin e roleve dhe përgjegjësie.

Për këto arsye, reforma e nisur në shërbimin e ujitjes dhe kullimit konsiston:

Së pari, në ri-konceptimin e rolit, përgjegjësieve dhe funksioneve të Bordeve të Kullimit. Edhe emërtimi i tyre propozohet të ndryshojë në “Drejtori të Ujitjes dhe Kullimit”.

Në këtë kuadër, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit rural dhe Administrimit të ujërave (MBZHRAU), nëpërmjet Drejtorive të Ujitjes dhe Kullimit, do të jetë përgjegjëse për operimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës kryesore që përfshin disa rezervuarëve të mëdhenj të ujitjes, kanaleve kryesore ujitës dhe kullues, kanalet e ujrave të larta, stacioneve të pompimit për kullim (hidrovoret) dhe argjinaturat lumore e detare për mbrojtjen nga përmytjet.

Së dyti, në decentralizimin e kompetencave dhe kalimin tek bashkitë të përgjegjësieve të menaxhimit të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të transferuar në pronësi të tyre. Transferimi i kësaj infrastrukture kushtëzohet me ruajtjen e destinacionit dhe përgjegjësinë për mirëmbajtjen dhe operimin e tyre. Bashkitë kanë autoritetin dhe kapacitetin për të menaxhuar më mirë dhe investuar në sistemet e ujitjes dhe kullimit. Ato marrin rol parësor në menaxhimin e sektorit të ujitjes dhe kullimit, nëpërmjet:

- transferimit të drejtës së pronësisë të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit dhe kalimin e përgjegjësive për operimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së transferuar;
- përcaktimit të tarifave të shërbimit të ujitjes/kullimit dhe mbledhjen e tyre duke synuar një mbulim gradual të kostove.
- mobilizimit të burimeve të tjera financiare nga vetë ato apo sigurimit të granteve nga buxheti i shtetit, mbi bazën e nevojave dhe performancës së arritur.
- rolin nxitës të tyre në krijimin si dhe mbështetjen për fuqizimin dhe mirëfunksionimin e OPU-ve.

Organizimi i shërbimit të ujitjes nga vetë bashkia do të bëhet në përshtatje me madhësinë e skemës ujitëse, gjendjen e saj, traditën, shkallën e kooperimit të fermerëve etj. Bashkitë mbështeten nga buxheti i shtetit me investime për rehabilitimin e skemave ujitëse, mjete për pastrimin e kanaleve ujitës dhe kullues, personel etj.

Së treti, një qasje e tillë e decentralizuar nënkupton edhe përfshirjen e **OPU-ve**, si nivelin më të ulët të administrimit, për sa, që ato janë krijuar dhe funksionojnë në mënyrë efektive. Në çdo rast, këto të fundit, mund të krijohen dhe funksionojnë në bashkëpunim dhe mbikqyrjen e bashkive.

Edhe pse pa një rol të qënësishëm, rastet kur është vërejtur një funksionim i OPU-ve, lidhen me një rol de facto të rëndësishëm të njësive të qeverisjes vendore ku ka operuar OPU-ja.

OPU –ja mund të luajë një rol jo të parëndësishëm në shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e skemave ujitëse, brenda zonës së saj të shërbimit të ujitjes dhe sigurimit të ujit për ujitje për anëtarët e saj. Gjithsesi shkalla dhe masa e këtij roli do të përcaktohet nga shkalla e gadishmërisë dhe interesit për pjesëmarrje efektive të fermerëve në këto struktura. Bazuar në përvojën e shkuar dhe vlerësimet e bëra, pritet që procesi i rritjes së rolit të OPU-ve të jetë afatgjatë. Ndaj në kushtet kur në një fshat a zonë të caktuar, OPU-të nuk janë ngritur ende apo janë jo-efektive, roli i tyre do të kryhet nga vetë bashkia.

Në zbatim të strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore, ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në nenin 27 “Funksionet e bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit”, ka përcaktuar se bashkitë janë përgjegjëse për : “Administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të transferuar në pronësi të tyre, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj”.

Për realizimin e këtij funksioni, Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr.1108, date 30.12.2015, “Për transferimin, nga Ministria e bujqësisë, zhvillimit rural dhe administrimit të ujërave të bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit”. Nëpërmjet këtij vendimi është realizuar transferimi në pronësi i inventarit të rrjetit të ujitjes dhe kullimit që janë administruar nga Bordet e Kullimit nën varësinë e MBZHRAU, si dhe transferimi i një pjese të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të bordeve të kullimit në 61 bashkitë, përfshirë zyra, ekskavatore, punonjes etj.

Gjithashtu, për vitin 2016, Këshilli i Ministrave, ka miratuar vendimin nr. 90, datë 4.02.2016 “Për detajimin e fondit të investimeve për funksionin e ujitjes dhe kullimit sipas bashkive”, nëpërmjet të cilit bashkitë përfitojnë nga buxheti i shtetit 2,45 miliard lekë për rehabilitimin e skemave ujitëse dhe blerjen e 61 ekskavatoreve të rinj.

Ndërsa , me VKM, nr. 1107, datë 30.12.2015 “Për krijimin e bordeve rajonale të kullimit Lezhë, Durrës, Fier dhe Korçë”, tashme janë krijuar 4 borde rajonale kullimi nga 13 të tillë, që ekzistonin më parë.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën edhe legjislacionin e vendit, në fuqi.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përmban 59 nene gjithësej, të përfshirë në shtatë krerë.

Në kreun I, (Dispozita të përgjithshme) të projektligjit, përveç qëllimit, përcaktohen parimet kryesore në administrimin e sistemeve të ujitjes dhe të kullimit ku sanksionohet që përfituesit duhet të përballojnë shpenzimet e funksionimit dhe të mirëmbajtjes së tyre. Në nenin 5, përcaktohen edhe strukturat përgjegjëse për administrimin e ujitjes dhe të kullimit duke filluar me ministrinë përgjegjëse (MBZHRAU), Drejtoritë e Ujitjes dhe Kullimit në varësi të saj, bashkitë dhe OPU-të.

Ndërsa neni 6, përmban detyrat dhe përgjegjësitë e ministrisë, si organi kryesor përgjegjës për administrimin e ujitjes dhe të kullimit.

Në kreun II, “Infrastruktura e ujitjes dhe kullimit” përcaktohet detyrimi për mbajtjen e inventarit të infrastrukturës përkatëse nga ministria dhe bashkitë. Po kështu, përcaktohen procedurat për transferimin e infrastrukturës së ujitjes, kullimit dhe veprave të mbrojtjes nga përmytja dhe detyrat e strukturave përgjegjëse për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

Kreu III, përcakton krijimin e drejtorive të ujitjes dhe kullimit, si struktura në varësi të MBZHRAU si dhe detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të tyre në sistemet e ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmytjet. Veprimtaritë që realizohen nga këto drejtori financohen nga Buxheti i Shtetit i miratuar për ministrinë.

Në kreun IV, të projektligjit përcaktohen, detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të bashkive për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të transferuar në pronësi të tyre.

Burimet kryesor i të ardhurave, për përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësitë të parashikuara, janë tarifa vjetore e mirëmbajtjes së infrastrukturës dhe tarifa e shërbimit të ujitjes, që do paguhet nga vetë fermerët përfitues nga këto shërbime. Tarifa vjetore e mirëmbajtjes së infrastrukturës së ujitjes dhe tarifa e shërbimit të ujitjes miratohen nga këshilli i bashkisë-së përkatëse.

Po kështu, si burime të tjera parashikohen të ardhurat e veta, grantet nga buxheti i shtetit, donacionet e ndryshme, etj.

Kreu V, “Organizatat e Përdoruesve të Ujit” përcakton statusin juridik të OPU-ve si person juridik, me vetëfinancim, që nuk ushtron veprimtari fitimprurëse, qëllimin e krijimit, të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të tyre, statutin dhe regjistrimin, procedurën e krijimit dhe organet drejtuese, burimet e të ardhurave etj.

NË KREUN E VI-TË, (Mbikëqyrja e sektorëve të ujitjes dhe të kullimit) përcaktohen mbajtja e regjistrave, llogarive dhe kontrolli financiar i llogarive

dhe të ardhurave vjetore si dhe mbikqyrja teknike për të siguruar një monitorim të vazhdueshëm të procesit të mirëmbajtjes dhe shfrytëzimit të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit. Në nenin 53, të këtij kreu përcaktohen edhe kundërvajtjet administrative.

Ndërsa, **në kreun e fundit** (Dispozita kalimtare dhe të fundit), përcaktohet që Bordet e Kullimit të vazhdojnë të kryejnë funksionet e tyre deri në krijimin e Drejtorive të Ujitjes dhe Kullimit, për të mos krijuar boshllëk në kryerjen e këtyre shërbimeve si dhe nxjerja nga Këshilli i Ministrave dhe Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Në zbatim të këtij këtij ligji ngarkohen Këshilli i Ministrave dhe Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të nxjerrin aktet nënligjore. Ndërsa institucionet e ngarkuara për zbatimin e detyrave që përcaktohen në dispozitat e tij përfshijnë MBZHRAU, Drejtoritë e Ujitjes dhe Kullimit dhe bashkitë.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Administrimit të Ujërave dhe Tokës në MBZHRAU nëpërmjet një procesi konsultimi të gjerë me përfaqësues të komunitetetve të fermerëve, OPU-ve, Bordeve të Kullimit, bashkive dhe institucione të tjera qëndrore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Zbatimi i këtij projektligji nuk ka efekt financiar shtesë për buxhetin e shtetit. Shpenzimet për menaxhimin e infrastrukturës së ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmytjet për MBZHRAU dhe bashkitë parashikohen në PBA.

Bashkelidhur formati standart për efektet financiare në buxhetin e shtetit të këtij projektligji.

MINISTRI

EDMOND PANARITI